KËSHILLI I EUROPËS

GJYKATA EUROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I KATËRT

MBI PRANUESHMËRINË E ANKIMIT NR.12310/04
ZYFLLI KUNDËR SHQIPËRISË

VENDIM
STRASBURG
27 shtator 2005

Në çështjen Zyflli kundër Shqipërisë,

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i katërt), e mbledhur më 27 shtator 2005, me trup gjykues të përbërë prej:

sir Nicolas BRATZA, President
z. J.CASADEVALL
z. M.PELLONPAA
z. R. MARUSTE
z. K.TRAJA
znj. L. MIJOVIC
z. J. SIKUTA, gjykatës
dhe znj. F. ELENS-PASSOS, zëvendësregjistrues i seksionit,

duke pasur parasysh ankimin e mësipërm, depozituar më 27 janar 2004;

duke pasur parasysh informacionin mbi faktet e paraqitura nga pala shqiptare, me kërkesë të Gjyqtarit Relator, në bazë të nenit 49 § 2 (a) të rregullores së Gjykatës dhe komenteve në përgjigje të këtij informacioni, të paraqitura nga ankuesi,

pas shqyrtimit të ankimit, vendos si më poshtë:

FAKTET

Ankuesi, z.Bujamin Zyflli, është shtetas shqiptar i lindur në 1945. Në kohën e depozitimit të ankimit në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut, ai vuante dënimin në burgun e Krujës. Aktualisht jeton në qytetin e Devollit.

A. Rrethanat e çështjes

Siç janë parashtruar nga ana e ankuesit dhe nga pala shqiptare, rrethanat e çështjes, në bazë të nenit 49 § 2 (a) të rregullores së Gjykatës, mund të përmblidhen si më poshtë:

1. Parashtrimet e ankuesit

Më 3 prill 1989, ankuesi u arrestua dhe u akuzua për vrasje dhe armëmbajtje pa leje.

Më 25 maj 1989, Gjykata e Rrethit të Korçës e shpalli atë fajtor, duke e dënuar me njëzet vjet burg.

Nga periudha qershor 1989 deri në gusht 1992, ankuesi vuajti dënimin në burgun e Batërit dhe gjatë kësaj kohe iu kërkua të kryente punë të detyrueshme në një minierë.

Nga viti 1992 deri në 1997 ai u transferua në tre burgje të ndryshme.

Në bazë të ligjit "Për amnistinë" të 13 nëntorit 1989, ankuesit iu falën katër vjet, dhjetë muaj dhe dy ditë burg nga dënimi.

Në bazë të dekretit të faljes të nxjerrë në 28 dhjetor 1995, atij iu dha e drejta e uljes së dënimit me dy vjet.

Në 1996, ankuesi argumentoi se i ishin ulur dy vjet, tre muaj e gjashtë ditë nga dënimi, në bazë të dy dekreteve të faljes.

Më 13 mars 1997 ai u largua nga burgu, në kohën kur shteti nuk mbante dot burgjet nën kontroll dhe Shqipëria u përfshi nga trazirat.

Sipas ankuesit, ligji "Për amnistinë" i vitit 1997 i dha atij të drejtën e uljes së dënimit me dy vjet.

Më 11 shtator 2000 ai u dorëzua pranë autoriteteve, me qëllim vuajtjen e pjesës së mbetur të dënimit, i cili sipas ankuesit konsistonte në disa muaj.

Më 5 shkurt 2003 dhe 25 mars 2004, në vijim të kërkesave të ankuesit, Gjykata e Rrethit të Krujës, i dha gjithsej 6 muaj ulje dënimi për sjellje të mirë.

Në 2003, ankuesi depozitoi dy kërkesa pranë gjykatësit përgjegjës për ekzekutimin e dënimeve, për uljen e dënimit si më poshtë: a) nëntë muaj dhe gjashtëmbëdhjetë ditë që i korrespondojnë tre viteve punë të detyrueshme të vuajtura në burgun e Batërit; b) dy vjet, tre muaj dhe gjashtë ditë, në bazë të dy dekreteve të faljes të dhëna në 1996; c) një muaj që konsiston në periudhën e ndalimit të paraburgimit; dhe d) dy vjet në bazë të ligjit "Për amnistinë" i vitit 1997. Sipas ankuesit, ndalimi i tij pas vitit 2001 ka qenë i paligjshëm.

Në 22 tetor dhe 13 nëntor 2003, Gjykata e Rrethit të Krujës, vendosi të pushojë procedimet në lidhje me kërkesat e ankuesit për çështjet që duheshin hequr nga lista. Ankuesi nuk i apeloi vendimet e mësipërme.

2. Parashtrimet e palës shqiptare

Pas një kërkese për informacion mbi faktet, në bazë të nenit 49 § 2 (a) të rregullores së Gjykatës, pala shqiptare deklaroi më 1 korrik 2004 se ankuesit i kishin mbetur për të vuajtur tetë muaj dhe katërmbëdhjetë ditë nga dënimi.

Ata parashtruan se ankuesit i ishte dhënë e drejta e uljes së dënimit për periudhat e mëposhtme: a) dy vjet sipas dekretit të faljes së 28 dhjetorit 1995; b) katër vjet, dhjetë muaj e dy ditë në bazë të amnistisë së 13 nëntorit 1989; c) një muaj për ndalimin e paraburgimit; d) gjashtë muaj të dhëna nga gjykata vendase për sjellje të mirë; e) një muaj e njëzet ditë që i korrespondojnë trembëdhjetë ditëve punë të detyrueshme.

Për sa i përket pretendimit të ankuesit për ulje të dënimit mbi bazën e punës së detyrueshme, pala shqiptare parashtroi se dosja e burgut të ankuesit specifikonte se gjatë tre viteve në burgun e Batërit ai kishte kryer gjithsej trembëdhjetë ditë punë të detyrueshme gjatë periudhës qershor - korrik 1989, duke fituar një ulje dënimi prej një muaj e njëzet ditësh.

Në lidhje me periudhën tjetër të vuajtjes së dënimit në burgun e Batërit, nuk ekziston në dosjen e burgut ndonjë dokument që të vërtetojë se ankuesi është konsideruar i aftë për të punuar në minierë. Megjithatë, pala shqiptare vëren se ankuesi nuk ka depozituar asnjë kërkesë për vërtetimin e fakteve pranë gjykatave vendase, me qëllim rishikimin e dosjes së burgut.

Sipas palës shqiptare, ankuesit nuk i është dhënë asnjë ulje dënimi në 1996, as nuk është kualifikuar për falje në bazë të ligjit "Për amnistinë" të vitit 1997.

3. Lirimi i ankuesit

Më 14 mars 2005, ankuesi u lirua nga burgu pas vuajtjes së dënimit.

B. Legjislacioni i brendshëm përkatës

1. Kodi i Procedurës Civile

Dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Civile vijojnë si më poshtë:

Neni 388

"Kur nga një fakt varet lindja, ndryshimi ose shuarja e të drejtave personale apo pasurore të një personi dhe akti që vërteton atë është zhdukur, ka humbur dhe nuk mund të bëhet përsëri ose nuk mund të merret me ndonjë rrugë tjetër, personi i interesuar ka të drejtë të kërkojë që fakti të vërtetohet me vendim të gjykatës së shkallës së parë."

2. Dekretet për falje dënimi

a) Në bazë të dekretit të faljes, të nxjerrë më 28 dhjetor 1995, Presidenti i Republikës, duke ushtruar të drejtën e faljes për personat e dënuar, vendosi që ankuesit t'i jepet e drejta e uljes së dënimit me dy vjet.

b) Në 1996, Presidenti i Shqipërisë, në bazë të kompetencave të tij të posaçme, nxori gjashtë dekrete për falje dënimi, por sipas palës shqiptare, ankuesi nuk ishte përfshirë në asnjërin prej tyre.

3. *Ligji "Për amnistinë*"

Neni 7 i ligjit "Për amnistinë" i 13 nëntorit 1989, parashikonte se të gjithë personat e dënuar në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, gëzonin të drejtën e faljes së një të katërtës së

dënimit të tyre.

ANKIMIMI

Duke u bazuar në nenin 5 § § 1 (a) dhe 5 të Konventës, ankuesi pretendonte se ndalimi i tij nga viti 2001 deri në 2005 nuk kishte bazë ligjore. Ai gjithashtu pretendonte se nuk kishte gëzuar një të drejtë të zbatueshme për kompensim.

LIGJI

Bazuar në nenin 5 § § 1 (a) dhe 5 të Konventës, ankuesi u ankua se ndalimi i tij ishte i "paligjshëm" dhe se ai nuk gëzonte të drejtë të zbatueshme për kompensim.

Neni 5 i Konventës, për çështjen në fjalë, vijon si më poshtë:

"1. Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijojnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj:

a) kur burgoset ligjërisht, pas një dënimi të dhënë nga një gjykatë kompetente;

…

5. Çdo person, që arrestohet ose burgoset në kundërshtim me dispozitat e këtij neni, ka të drejtën e dëmshpërblimit."

a) Ankuesi

Ankuesi kundërshtoi arsyetimin e vendimeve të gjykatave vendase, të cilat sipas tij ishin absurde. Ai refuzoi të paraqiste ndonjë kërkesë pranë gjykatave për një pushim të procedimit dhe theksoi se i kishte nisur disa letra Presidentit të Republikës, Avokatit shqiptar të Popullit dhe politikanëve, duke pretenduar se ndalimi i tij ishte i paligjshëm, pasi periudha e dënimit të vendosur nga gjykatat kishte përfunduar.

Ankuesi pohoi se autoritetet nuk kishin mundur të përditësonin dosjen e tij të burgut gjatë transferimeve të shumta në burgje të ndryshme dhe se dosja ishte dëmtuar pjesërisht, kur shteti humbi kontrollin e burgjeve gjatë periudhës së trazirave në Shqipëri. Për pasojë, ndalimi i tij ishte zgjatur për shkak të neglizhencës së autoriteteve të burgut. Sipas ankuesit, ndalimi i tij nga viti 2001 deri në 2005, përmblidhej në ndalimin "sine titulo".

b) Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata vëren fillimisht se ankuesi u ndalua në vitin 1989 pas "dënimit nga një gjykatë kompetente". Për pasojë, ndalimi i tij u realizua në lidhje me përcaktimet e nenit 5 § 1 (a). Nuk ka dyshim se dënimi me burgim ishte i ligjshëm në bazë të legjislacionit shqiptar. Gjithashtu, nuk mund të thuhet se ndalimi i ankuesit nuk ishte sipas qëllimit për të cilin privimi i lirisë lejohet, në bazë të nenit 5 § 1 (a). Përfundimisht, nuk ekziston asnjë e dhënë që të vërtetojë se dënimi i tij nuk ishte i bazuar në fakte apo se ishte arbitrar.

Pavarësisht nga fakti se ndalimi i ankuesit u krye në vitin 1989, d.m.th. përpara hyrjes në fuqi të Konventës në Shqipëri (2 tetor 1996), situata me të cilën ankuesi u përball, vazhdoi edhe pas datës së lartpërmendur. Pra, Gjykata ka juridiksion "ratione temporis" për të shqyrtuar nëse ndalimi, në bazë të pretendimit të ankuesit se periudha e burgimit të tij është keqllogaritur, ishte i paligjshëm.

Gjykata rithekson se rregulli i shterimit të mjeteve të brendshme juridike, i referuar në nenin 35§1 të Konventës, i detyron ankuesit të përdorin mjetet juridike që janë normalisht të disponueshme dhe të mjaftueshme në sistemin e brendshëm ligjor, për t'iu dhënë mundësi atyre të adresojnë shkeljet e pretenduara. Ekzistenca e mjeteve juridike duhet të jetë e garantuar si në teori ashtu edhe në praktikë. Mungesa e kësaj garancie çon në mungesën e aksesit dhe efikasitetit të kërkuar. Neni 35 § 1 gjithashtu parashikon që para se të paraqiten në Gjykatën Europiane, ankimet duhet të paraqiten në organet e brendshme përkatëse, duke respektuar kriteret e legjislacionit vendas sa i takon formës dhe përmbajtjes së ankimit, por nuk duhet të ndiqet një adresim i tillë për mjetet juridike që nuk janë të përshtatshme dhe efektive (shih Aksoy v Turkey, nr.21987/93, §§ 51-52, ECHR 1996-VI, dhe Akdivar and Others v. Turkey, nr.21893/93, §§ 65-67, ECHR 1996-VI). Për më tepër, u takon autoriteteve vendase, veçanërisht gjykatave, që të interpretojnë legjislacionin vendas (shih Garcia Ruiz v Spain [GC], nr.30544/96, § 28, ECHR 1999-I).

Përsa i përket rastit në fjalë, Gjykata vëren se informacioni i paraqitur nga pala shqiptare

në lidhje me dosjen e burgut të ankuesit, tregon se ka të dhëna për vetëm dy muaj nga tre vitet e dënimit që ai vuajti në burgun e Batërit.

Gjykata vëren se përgjegjësia për mbajtjen e të dhënave të duhura i takon administratës së burgut. Të dënuarit nuk duhet të cenohen nga pamundësia e tyre në mbajtjen e të dhënave të tilla, dhe për pasojë periudha e ndalimit të tyre nuk duhet të zgjatet.

Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se kur përballet me një konflikt që ka të bëjë me rrethanat e sakta të çështjes, një shtet anëtar nuk mund të pretendojë të përmbushë detyrimet e tij sipas Konventës, nëse nuk paraqet të dhëna të plota të dosjeve të burgut. Në mungesë të dokumentacionit ose fakteve kundërshtuese, Gjykata mund të marrë për bazë deklarimet e ankuesit (shih mutandis mutandis Messina v. Italy, vendimi i 26 shkurtit 1993, Seria A, nr. 257-H, § 31).

Duke pasur këtë fakt parasysh, Gjykata çmon se në rastin në fjalë, ajo nuk përballet vetëm me një konflikt faktik që ka të bëjë me rrethanat e sakta të çështjes, por gjithashtu me një çështje të së drejtës, dhe për pasojë duhet të marrë një vendim mbi bazën e vendimeve të disponueshme të gjykatave vendase, ku përcaktohet nëse ankuesi ka kryer punë të detyrueshme gjatë vuajtjes së dënimit në burgun e Batërit apo është justifikuar për arsye shëndetësore.

Megjithatë, Gjykata vëren se në burgun e Batërit, të burgosurve u kërkohej të kryenin punë të detyrueshme në minierë, vetëm nëse ata plotësonin kushte specifike mjekësore (shëndetësore).

Gjykata çmon se është detyrë e gjykatave vendase të vendosin nëse ankuesi mund të kishte përfituar nga ligji “Për amnistinë” i vitit 1997 ose nëse ai ishte përfshirë në listën e të ndaluarve të cilët përfituan ulje dënimi në 1996.

Ankuesi nuk kundërshtoi as para Gjykatës së Apelit, as me një rekurs në Gjykatën e Lartë, përllogaritjen e periudhës së dënimit që i duhet të vuante ose ligjshmërinë e vendimeve të Gjykatës së Rrethit. Edhe Gjykata, nuk mundi të gjejë ndonjë arsye pse të paktën një nga këto mjete juridike nuk ishte përdorur.

Gjykata konstaton se ankuesi për pasojë nuk ka ezauruar të gjitha mjetet e brendshme juridike brenda kuptimit të nenit 35 § 1 të Konventës, dhe për këtë arsye ankimi i tij sipas nenit 5 § 1 duhet të konsiderohet i papranueshëm sipas kuptimit të nenit 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

2. Gjykata rithekson se neni 5 § 5 zbatohet në ato raste, ku plotësohen kushtet për të kërkuar kompensim sa i takon privimit të lirisë të realizuar në kushte, që bien në kundërshtim me paragrafët 1, 2, 3 ose 4 (shih Wassink v. the Netherlands, vendimi i 27 shtatorit 1990, Seria A, nr.185-A, fq. 14, § 38; Vachev v. Bulgaria, nr.42987/98, § 78, ECHR 2004-VIII). Për pasojë, e drejta për kompensim, në kuptimin e paragrafit 5, lind nëse autoritetet vendase apo gjykatat cenojnë të paktën njërin nga paragrafët paraprirës të nenit 5.

Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se në çështjen në fjalë, ankimi sipas nenit 5 § 1, duhet të konsiderohet i papranueshëm. Më tej vëren se ankimi përkatës, sipas nenit 5 § 5, nuk mund të shqyrtohet nga Gjykata.

Për këto arsye, Gjykata unanimisht,

E deklaron ankimin si të papranueshëm.

F. ELENZ-PASSOS
Zëvendësregjistrues

Nicolas BRATZA
President